



Thirrja është e hapur nga data 26.08.2026 deri me 04.09.2026

TERMAT E REFERENCES

KOMPANI DIZAJNUESE

Të dhënat mbi OJQ “Nevo Koncepti” dhe kërkesat për shërbimin e kampanjës .

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI
Objektiva	Realizimi i kampanjës për Asamblenë Komunale të Fëmijëve Prizren mbi temën “Pjesëmarrja e Fëmijëve në Vendimmarrjen Lokale dhe Promovimi i të Drejtave të Fëmijëve”

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga viti 2022 të muajit Qershor ka filluar të zbatojë projektin “Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” në Komunën e Prizrenit, asambleja përbëhet nga 45 antarë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat e mesme të ulëta të komunës së Prizrenit. Në Asamblenë Komunale të Fëmijëve janë të përfshirë komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian, gjithashtu në Asamblenë Komunale të Fëmijëve përfaqësohen edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat organizohen nga antarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

“Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe gjatë organizimit të ngjarjeve nga komuna e Prizrenit nëpërmjet krijimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në nivel të komunës nga 13 shkollat fillore të mesme të ulëta të komunës së Prizrenit.

Asambleja Komunale e Fëmijëve të Prizrenit është krijuar në vitin 2017 dhe përbëhet nga 43 Asamblesitë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat. Asambleja ka për qëllim avokimin dhe mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.



3. OBJEKTIVA

Qëllimi i këtij angazhimi është të kontraktohet një kompani dizajni kreative dhe me përvojë, e cila do të zhvillojë identitetin vizual dhe materialet promovuese për fushatën e Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Prizren, me fokus në **“Pjesëmarrjen e Fëmijëve në Vendimarrjen Lokale dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve”**.

Fushata ka për qëllim të promovojë zërin dhe pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin e institucioneve, komunitetit dhe publikut për rëndësinë e përfshirjes së fëmijëve në çështjet që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre. Përmes materialeve kreative dhe komunikimit publik, fushata do të pasqyrojë kërkesat, idetë dhe prioritetet e fëmijëve dhe do të promovojë bashkëpunimin ndërmjet fëmijëve, institucioneve lokale dhe komunitetit.

Kompania e përzgjedhur do ta mbështesë këtë proces përmes krijimit të materialeve grafike dhe promovuese, duke përfshirë posterë, infografika, materiale për rrjetet sociale, video të shkurtra dhe materiale të tjera relevante, të cilat do të komunikojnë në mënyrë të qartë dhe kreative mesazhet dhe kërkesat e fëmijëve.

Nevo Koncepti po kërkon të angazhojë një kompani kreative të dizajnit për të mbështetur zhvillimin dhe realizimin vizual të kësaj fushate dhe për të kontribuar në rritjen e zërit dhe pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimarrjen lokale.

4. KUALIFIKIMI DHE PËRVOJA E KOMPANISË

Kompania e përzgjedhur duhet të ketë aftësitë, përvojën dhe kapacitetet e nevojshme për zhvillimin dhe realizimin e materialeve kreative dhe promovuese për fushatën e Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Rahovec. **Kompania duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:**

- Të ketë përvojë të dëshmuar në dizajn grafik, zhvillim të identitetit vizual dhe krijim të materialeve promovuese;
- Të ketë së paku 3 vite përvojë në realizimin e fushatave kreative dhe materialeve për komunikim publik dhe/ose rrjete sociale;
- Të ketë përvojë në dizajnimin e posterëve, infografikave, materialeve për rrjete sociale, video-materialeve të shkurtra dhe produkteve të tjera vizuale;
- Të ketë aftësi për të zhvilluar materiale kreative dhe të përshtatshme për fëmijë dhe të rinj, duke përdorur gjuhë dhe elemente vizuale të qarta, tërheqëse dhe gjithëpërfshirëse;
- Të ketë përvojë ose njohuri në komunikimin dhe zhvillimin e fushatave që lidhen me të drejtat e fëmijëve, pjesëmarrjen e fëmijëve ose çështje sociale;
- Të jetë kreative, inovative, fleksibile dhe e hapur ndaj ideve dhe sugjerimeve të fëmijëve dhe ekipit të Nevo Konceptit;
- Të jetë në gjendje të punojë në mënyrë interaktive me përfaqësuesit e Asamblesë Komunale të Fëmijëve dhe të përfshijë idetë, kërkesat dhe mesazhet e tyre në materialet e fushatës;
- Të respektojë afatet kohore dhe të jetë fleksibile në përshtatjen e punës sipas nevojave dhe orarit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe koordinimi me ekipin e Nevo Konceptit dhe përfaqësuesit e Asamblesë Komunale të Fëmijëve;
- Të ketë portfolio të punëve të mëparshme në dizajn grafik, fushata kreative ose komunikim publik, e cila duhet të dorëzohet së bashku me ofertën;
- Të sigurojë që të gjitha materialet e zhvilluara respektojnë parimet e mosdiskriminimit, gjithëpërfshirjes, diversitetit dhe pjesëmarrjes së fëmijëve;



- Të punojë në përputhje me politikat dhe procedurat e Nevo Konceptit për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve;
- Të respektojë privatësinë, dinjitetin dhe sigurinë e fëmijëve gjatë procesit të zhvillimit dhe përdorimit të materialeve vizuale;
- Të mos përdorë fotografi, video, emra apo të dhëna të fëmijëve pa pëlqimin dhe autorizimin përkatës, në përputhje me politikat e mbrojtjes së fëmijëve.

Kompania duhet të demonstrojë gatishmëri për të bashkëpunuar ngushtë me Nevo Konceptin dhe Asamblenë Komunale të Fëmijëve gjatë gjithë procesit të zhvillimit dhe finalizimit të materialeve të fushatës.

4. DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE AFATI KOHOR

Angazhimi duhet të fillojë me datën 07.09.2026 dhe të planifikohet të përfundojë deri më 30 Shtator, të gjitha materialet punuese duhet të dorëzohen tek Menaxheri i Projektit.

Nr.	Detyrat	Afati Kohor
1.	Përgaditja e materialit për prezantim dhe përgjatë punëtorisë të mbështetet AKF Rahovec në krijimin e idesë për kampanjën.	Shtator 2026
2.	Takimi me Asamblenë Komunale të Fëmijëve, bashkëpunimi në grupe me antarët e Asamblesë, dhe draftimi i planit vizual të fushatës bashkë me antarët e AKF Rahovec.	Shtator 2026
3.	Dorëzimi i planit final dhe matrialeve promovuese tek menaxheri i projektit	30 Shtator 2026

5. PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet ti dërgojnë këto dokumente:

Aplikacionet duhet të dërgohen duke përfshirë këto dokumente:

- Kuptimi i detyrës dhe nëndetyrave të saj;
- Metodologjia;
- Propozimi financiar ;
- Curriculum Vitae (për individë);
- Certifikata e biznesit dhe referencat (për kompanitë).

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 04.09.2026** në prokurimi@nevokoncepti.org.



Save the Children



Sweden
Sverige



**NEVO
KONCEPTI**